



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura e VIII**

*Sesioni vjeshtor*

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 15**

**Prishtinë, më 12.4.2022, në orën 12:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204**

**PROCESVERBAL**

**Morën pjesë:** Verica Çeraniq, kryetare, Hydajet Hyseni Kaloshi dhe Bahrim Shabani, zëvendëskryetarë, Arjeta Fejza, Elmi Reçica, Shemsedin Dreshaj, , Miljana Nikoliq, Zoran Mojsilović, Jasmina Dediq, Milosh Perović, , Enis Kervan, Fadil Gashi, Fridon Lala dhe Bekim Arifi, anëtarë.

Munguan: Drita Millaku, Valentina Bunjaku Rexhepi dhe Adem Hodzha.

Të pranishëm të tjerë: Mirishahe Tasholli- KDI; Fiona Beka, asistente e GP VV; Arton Musliu- asistent i GP PDK; Zijush Ahmeti-SKKK dhe Celal Iliaz, Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasa Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi **Verica Çeraniq**, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me dt. 23.02.2022, 2.03.2022 dhe 15.03.2022.**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-076 për mbrojtjen e sekreteve tregtare, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti;**
- 4. Shqyrtimi i raportit plotësues për Projektligjin nr.08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës nr.08/1222/L-056 datë 21.12.2021, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti;**
- 5. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me dt. 23.2.2022, 2.3.2022 dhe 15.3.2022.**

**Kryetarja**, fillimisht e prezantoi anëtarën e re të komisionit, e cila vjen nga radha e GP të LS, Dragana Antonijeviq.

**Dragana Antonieviq**, përshëndeti kryetaren dhe anëtarët tjerë të komisionit. Ajo shprehu bindjen e saj se do të ketë atmosferë kolegjiale për funksionim të duhur të komisionit.

**Kryetarja**, theksoi se para vetës i kemi tre procesverbale, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo vërejtje eventuale. Njëherit kërkoi që të procedohen votimi të tre procesverbaleve në pako.

Pasi nuk pati propozime shtesë, kryetarja i hodhi në votim procesverbalet me dt. 23.2.2022, 2.3.2022 dhe 15.3.2022, dhe konstatoi se të njëjtat nuk miratohen pasi nuk morën votat e mjaftueshme.

**Hydajet Hyseni Kaloshi**, sa i përket votimit të procesverbaleve dhe çështjeve tjera, është krijuar një praktikë parlamentare e pa parë deri më sot, e cila po ndikon në funksionimin jo të drejtë të komisionit. Konsideron, se kur procesverbalet janë të hartuara mirë, pa vërejtje, apo sugjerime konkrete, të njëjtat duhet të miratohen. Propozimi i tij konkret ishte që këto tre procesverbale, përsëri të hodhën në votim.

**Kryetarja**, shprehu qëndrimin e saj se procesverbali me datë 2.3.2022 ka mund të korrigjohet me propozimin e dhënë të zot, Hyseni dhe i njëjti të miratohet. Pasi nuk janë marr votat e mjaftueshme, ajo propozoi që tri procesverbalet, të shqyrtohen dhe miratohen në mbledhjen e radhës.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-076 për mbrojtjen e sekreteve tregtare, me raport amendamente të Komisionit Funkcional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti;**

**Kryetarja**, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-076 për mbrojtjen e sekreteve tregtare. Komisioni funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, në mbledhjen e mbajtur më 29.3.2022, ka vendosur që raportin me 24 amendamente, t' ua procedojë Komisioneve të përhershme për shqyrtim dhe vlerësim.

Pasi nuk pati propozime shtesë, të njëjtat i hodhi në votim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në bazë të rezultatit të votimit: 6 vota për, kurse 7 deputetë të GP të Listës Serbe të përfaqësuar në strukturën e Komisionit, nuk kanë marrë pjesë në votim, nxori këtë:

### **Rekomandim**

- I. Projektligji nr.08/L-076 për mbrojtjen e sekreteve tregtare, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

- II. Komisioni shqyrtoi raportin me rekomandime të Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, dhe i njëjti nuk u miratua sepse nuk morri shumicën e nevojshme të votave.

**4. Shqyrtimi i raportit plotësues për Projektligjin nr.08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës nr.08/1222/L-056 datë 21.12.2021, me raport amendamente të Komisionit Funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti;**

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës nr.08/1222/L-056 datë 21.12.2021. Komisioni funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, në mbledhjen e mbajtur më 5.4.2022, ka vendosur që raportin plotësues me 4 amendamente t'ua procedojë Komisioneve të përhershme për shqyrtim dhe vlerësim. Pasi nuk pati propozime shtesë, të njëjtat i hodhi në votim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në bazë të rezultatit të votimit: 7 vota për, kurse 7 deputetë të GP të Listës Serbe të përfaqësuar në strukturën e Komisionit, nuk kanë marrë pjesë në votim, nxori këtë:

### **Rekomandim**

- I. Projektligji nr.08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës nr.08/1222/L-056 datë 21.12.202, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni shqyrtoi raportin plotësues me amendamente të Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, dhe i njëjti nuk u miratua sepse nuk morri shumicën e nevojshme të votave.

**Hydajet Hyseni Kaloshi**, theksoi se sipas procedurave parlamentare, të gjitha projektligjet kalojnë në Kuvend edhe pa rekomandimet e Komisionit tonë. Veçoi se kjo situatë e krijuar nuk ndryshon ligjshmërinë, por në praktikë, del se puna e komisionit është jo funksionale. Në bazë të përgjegjësisë, komisioni duhet të jetë më transparent dhe të punojë më shumë me qëllim që të tejkalohej këto pengesa, nga se është në interes të të gjitha komuniteteve.

**Elmi Reçica**, theksoi se pikat e rendit duhet të procedohen në mënyrë të rregullt, për shkak të mos krijohet obstrukcion në komision, nga se janë në interes të të gjithëve. Gjithashtu, pajtohet me vërejtjet e nënkryetarit, zot. Hyseni, që si komision të jemi më unik dhe të tejkalohej pengesat e shumë çështjeve, sidomos për ligjet ekonomike dhe vendimet tjera. Konsideron se Qeveria duhet të jetë më azhur, të krijojë një frymë komunikimi më të mirë që të mos jemi para situatave të tilla.

Jemi në dijeni me qëndrimin e GP të LS, ku ata janë duke i bojkotuar mbledhjet e Seancave dhe të Komisioneve. Edhe në periudhat e ardhshme do të ketë raste ku do të shqyrtohen çështje të natyrave të ndjeshme, andaj është mirë të punojmë bashkërisht për eliminimin e problemeve të tilla.

**Kryetarja**, sa i përket çështjes së votimit, tha se secili anëtarë i komisionit ka të drejtë vote në bazë të bindjeve të veta, pavarësisht a është në pozitë apo opozitë.

## **5. Të ndryshme**

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

**Verica Çeraniq,**  
**Kryetare e Komisionit**

---